



AGJENCIA KOMBËTARE E
PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

ZBATIMI I PROGRAMEVE TË NXITJES SË PUNËSIMIT



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Embassy of Switzerland in Albania
Ambasada e Zvicrës në Shqipëri




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE
DHE EKONOMISË



Empowered lives.
Resilient nations.

PËRMBAJTJA



PROGRAMET DHE PËRFITUESIT

Programet e nxitjes së punësimit

PROGRAMET E NXITJES SË PUNËSIMIT

PROGRAMI I PUNËSIMIT

PROGRAMI I FORMIMIT NËPËRMJET PUNËS

PROGRAMI I PRAKTIKËS PROFESIONALE

PROGRAMI I VETËPUNËSIMIT

PROGRAMI I PUNËVE PUBLIKE NE KOMUNITET



**PROGRAME PUNËSIMI
TË PERSONAVE TË
DALË TË PAPUNË SI
PASOJE E COVID-19**

**Programi i punësimit
katërmujor**

**Programi i punësimit
tetëmuor:**

**Programi i punësimit
12 muor**

KARAKTERISTIKAT THELBËSORE




Nevojat dhe profili i punëkërkuessit duhet të përshtatet me kërkesat e vendit të lirë të punës, të ofruar nga punëdhënësi.

IDENTIFIKIMI I NEVOJAVE – PUNËKËRKUESI NË FOKUS

PLANI INDIVIDUAL I PUNESIMIT						
Zyra e Punes	DRSHKP Tiranë					
Emri i specialistit						
Të dhënat e punëkërkuesit			Referuar jashte ZP		Po/Jo	
Emri	Agim	Nivelet e punesueshmerise	Përmbledhje e vështirësive në tregun e punës / drop box	Referuar jashte ZP per probleme social-shendetesore	Jo	
Mbiemer	Hoxha	Niveli i tretë i punësueshmërisë	Kompetencat	Koment		
Numri personal (ID)	I70818074D		Nivel i ulet arsimor, Pa profesion			
Numri ne Sistem	517656		Pengesa personale			
Adresa e banimit	Tiranë/Njësia bashkiake Nr.5		Ka pengesa shëndetësore			
Nr telefoni			Vulnerabiliteti	Referuar per sherbime te specializuar ne OJF	Jo	
Profesioni	7512 - Bukëpjekës		Prindër i vetëm, Papunësi afatgjatë mbi 12 muaj, Person mbi 50 vjeç	Koment		
Arsimi	Arsim i mesëm i ulët (9-vjeçar)	8/31/58	Motivimi në punë			
Ditëlindja			Pa aftësi dhe eksperiencë në kërkimin e punës, Pritshmëri jo realiste, I dekurajuar			
Kategoria	NE					
Qellimi i punesimit: vlersim nga intervista						
Zhvillimi I Qellimit per punesim: Çfarë ju nevojitet të bëni për të arritur qëllimet tuaja? Procesi i emërimit të objektivave të punësimit dhe aktiviteteteve.	Zhvillimi i aktiviteteteve/veprimet per tu ndermarre:	Referuar ne sherbimet ZP	Komente qe detajojne sherbimin e zgjedhur	Data e propozuar	Data e perfundimit	Kostot
		Keshillim i specializuar	Puna dhe të nxënit në grup, Eksplorimi i botës së punës		1/30/20	
		Start Smart	Po		2/12/20	
		Formim profesional	Punëtor duralumini		6/30/20	
		Praktika profesionale				
		Programe formimi ne pune				
		Programe subvencionimi	9510 - Punëtorë për shërbime të ndryshme në rrugë		8/2/20	
		Program Vetepunesimi				
		Pune komunitare				
		Dalja ne TP (Punesim)	Ndermjetesim		8/2/20	
Unë kam lexuar dhe i kam kuptuar plotësisht kushtet dhe shërbimet që do të më ofrohen nga zyrat e punësimit dhe ofruesi i shërbimit. Unë dëshmoj se plani individual i punësimit është përgatitur në bashkëpunim me specialistin e zyrës dhe ka marrë pëlqimin tim.						
Emri Mbiemri _____						
Nënshkrimi _____						
Data _____						

PUNËKËRKUESIT ME TË DREJTË PËR FITIM



NUMRI I PËRFITUESVE PËR CDO PUNËDHËNËS



Punëdhënësit kanë të drejtë të aplikojnë në më shumë se një program



Punëdhënësit me 5 punonjës ose me shume mund të aplikojnë

Punëdhënësit me deri në 5 punonjës mund të aplikojnë për maksimumi dy pjesëmarrës



për një numër punëkërkuesish jo më të madh se 20% të fuqisë punëtore aktuale,

por jo më shumë se 21 pjesëmarrës.

PËRSHKRIM I PROGRAMEVE DHE PËRFITIMEVE

Çfarë është **PROGRAMI I PUNËSIMIT**?

PROGRAMI I PUNËSIMIT është një program NJË VJECAR PUNËSIMI, në të cilin nevojat e punëkërkuësit përshtaten me kërkesat për aftësi të vendit të lirë të punës, të ofruar nga punëdhënësi. Paga përcaktohet në kontratën e punës në përputhje me pozicionin përkatës dhe nivelin e pagave në treg.

PËRFITIMET PËR PUNËDHËNËSIN

Kontributet e detyrueshme

12 muaj

16.7% e pagës
minimale

Paga

4 muaj

100% e pagës
minimale

DISBURSIMI I FINANCIMIT TË PAGËS TEK PUNËDHËNËSI

Persona me aftësi të kufizuar



Viktima të trafikimit, të dhunës në familje apo viktima të dhunës me baza gjinore, Romë dhe Egjiptianë



Pupa që përmbushin kriteret e përgjithshme



M 1 M 2 M 3 M 4 M 5 M 6 M 7 M 8 M 9 M 10 M 11 M 12

TARGET GRUPI

1. Të rinjtë me moshë nën 29 vjeç;
2. PuPa afatgjatë;
3. Punëkërkuesit me moshë mbi 45 vjeç;
4. PuPa të pakualifikuar;
5. PuPa, të kthyer prej jo më shumë se dy vjetësh nga emigracioni;
6. Punëkërkuesit që përfitojnë ndihmë ekonomike, duke trajtuar me prioritet përfituesit e ndihmës ekonomike, qe parashikohet të dalin nga skema e ndihmës ekonomike në vitin përkatës dhe atë pasardhës;
7. Punëkërkuesit që marrin pagesa papunësie për më shumë se 3 muaj,
8. Personat me aftësi të kufizuara;
9. Viktimat e trafikimit, të dhunës me bazë gjinore dhe viktimat e dhunës në familje;
10. Punëkërkuesit nga komuniteti rom dhe egjiptian;
11. Personat që kanë përfunduar kursin e formimit profesional ose programin e formimit nëpërmjet punës dhe janë ende të papunë 6 muaj pas përfundimit.

Çfarë është **PROGRAMI I FORMIMIT NËPËRMJET PUNËS?**

PROGRAMI I FORMIMIT NËPËRMJET PUNËS ka si qëllim trajnimin në punë të PuPa, në të cilin nevojat e tyre përshtaten me kërkesat për aftësi të vendit të lirë të punës, të ofruar nga punëdhënësi. Kohëzgjatja e subvencionimit të këtij programi do të jetë për një periudhë 4-mujore, për të gjitha profesionet. Gjithashtu, programi subvencionon edhe 8 muaj të tjerë nëse punëdhënësi lidh kontratë punësimi me PuPa. Plani individual i trajnimit hartohet nga punëdhënësi si pjesë e formularit të aplikimit sipas një formati të miratuar. Çdo punëdhënësi cakton të paktën një trajner për çdo grup përfituesish nga një deri në shtatë persona përfitues, të përfshirë në program.

PËRFITIMET PËR PUNËDHËNËSIN

Kontributet e Detyrueshme

4 + 8 muaj

16.7% e pagës minimale

Paga

4 muaj

100% e pagës minimale

Trajner

4 muaj

2.000 lekë për çdo përfitues

DISBURSIMI I FINANCIMIT TË PAGËS TEK PUNËDHËNËSI

Kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore



Paga për cdo të trajnuar



Trajneri në kompani



M 1 M 2 M 3 M 4 M 5 M 6 M 7 M 8 M 9 M 10 M 11 M 12

TARGET GRUPI

PuPa të
pakualifikuar në
profesionin në të
cilin do të marrin
pjesë në program.

What's this?





Çfarë është PROGRAMI I PRAKTIKAVE PROFESIONALE?

Programi i praktikave profesionale ka si qëllim të garantojë tranzicion të shpejtë në tregun e punës, në të njëjtën fushë ose në një fushë të ngjashme me atë, në të cilën ka studiuar i diplomuari. Kohëzgjatja e subvencionimit të këtij programi do të jetë për një periudhë 6 mujore

PËRFITIMET PËR PUNËDHËNËSIN

6 muaj

50% e pagës
minimale



DISBURSIMI I FINANCIMIT TË PAGËS TEK PUNËDHËNËSI

Paga për cdo të trajnuar



M 1

M 2

M 3

M 4

M 5

M 6

M 7

M 8


M 9

M 10


M 11

M 12


TARGET GRUPI



PuPa të cilët janë të sapodiplomuar, deri në 24 muaj pas diplomimit.



TARGET GRUPE ME PËRFITIME TË SHTUARA



PËRFITIME TË TJERA PËR PUNËKËRKUESIN



Bonus për shpenzimet e transportit

- vendbanimin mbi 2 km nga vendi i punës - 1,600 lekë në muaj



Subvencionim për ndjekjen e kopshteve dhe çerdheve për fëmijët në ngarkim - 3.000 lekë në muaj



Përshtatjen e arsyeshme të vendit të punës për personat me aftësi të kufizuar - Deri në shumën 200.000 ALL (dyqind mijë) për punëdhënësit.

Çfarë është **PROGRAMI I VETËPUNËSIMIT** ?

Programi i vetëpunësimit është program njëvjeçar për nxitjen e punësimit i cili synon nxitjen e sipërmarrjes tek punëkërkuesit e papunë të cilët kanë një ide biznesi, nëpërmjet trajnimit për sipërmarrjen dhe zhvillimin e planeve të biznesit për aplikuesit dhe grantit për përfituesit. Ky program zbatohet bazuar në një proces të drejtë dhe konkurrues aplikimi

CFARË MBULON PROGRAMI

TRAJNIME

mbi sipërmarrjen dhe
përgatitjen e planit të
biznesit,

NDIHMË ME GRANTE NË VLERË DERI NË 500.000 LEKË

për çdo plan biznesi të
zhvilluar me sukses që është
miratuar në kuadër të
procesit të përzgjedhjes.

SHPENZIMET PËR VLERËSIMIN E PLANIT TË BIZNESIT

të të gjithë pjesëmarrësve, në
vlerën jo më shumë se 3.000
(tre mijë) lekë për çdo plan
biznesi, sipas çmimeve të
tregut për këtë lloj
ekspertize.

DISBURSIMI I GRANTIT

Të gjithë përfituesit që kanë firmosur Kontratën Standarte përfitojnë një grant për ngritjen e biznesit në vlerën deri në 500.000 lekë.

Te gjitha shpenzimet që do të mbulohen nga granti duhet të pasqyrohen në planin e biznesit **por në çdo rast nuk mund të përfshijnë:**

- a. qiramarrjen e ambienteve për zhvillimin e veprimtarisë së biznesit;
- b. pagat dhe kontribute (sigurimet shoqërore e shëndetësore, taksa).
- c. blerjen e pasurive te paluajtshme.

Çdo shpenzim që nuk është paraqitur në biznes planin e miratuar apo që është kryer para lidhjes së marrëveshjes për grantin, nuk do të miratohet si shpenzim i pranueshëm.

Të gjitha shpenzimet e grantit duhet të realizohen përmes transaksionit bankar të biznesit apo përmes kuponëve tatimorë (fature me TVSh). Çdo blerje me para në dorë (kesh) e cila nuk mund të dëshmohet është e pa pranueshme.

TARGET GRUPI

Pu. Pa. të cilët kanë
një ide biznesi

What's this?



PROCEDURA E ZBATIMIT

Promovimi

AKPA publikon informacionin e nevojshëm në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në platforma të tjera (faqe interneti, media sociale, shtypit, etj) në lidhje me zbatimin e programeve dhe informon punëkërkesit e papunë të interesuar.

Aplikimi

Të gjithë kandidatët do të kenë 30 ditë kohë për të plotësuar e më pas dorëzuar aplikimet e tyre nëpërmjet portalit eAlbania. Gjatë kësaj periudhe ZP do të jenë në dispozicion për të ndihmuar e suportuar të gjithë aplikuesit në plotësimin e formularit. Struktura vendore e punësimit verifikon plotësimin e kushteve formale paraprake të aplikimit dhe përputhshmërinë e tij me rregullat e zbatimit të këtij programi dhe kujdeset të përjashtojë të gjitha aplikimet e pasakta apo duplikimet.

Trajnimi

Të gjitha aplikimet që plotësojnë kriteret paraprake dërgohen në strukturën rajonale ku, në bashkëpunim me ofruesit e arsimit dhe formimit profesional bëhet përgatitjen e listave të trajnimeve në varësi të numrit të aplikimeve. Trajnimi i ofruar nga ofruesit e arsimit dhe formimit profesional do të zgjasë 3 javë kalendarike dhe do të zhvillohet në 3 module: i) moduli për konsolidimin e idesë së biznesit; ii) moduli për sipërmarrjen dhe iii) moduli për zhvillimin e planit të biznesit. Në përfundim të trajnimit do të zhvillohet një test me shkrim për verifikimin e njohurive të marra nga secili prej pjesëmarrësve gjatë trajnimit. Aplikuesit të cilët kalojnë me sukses testimin me shkrim, kanë të drejtë të dorëzojnë biznes planin pranë Drejtorisë Qendrore.

PROCEDURA E ZBATIMIT

Vlerësimi

Vlerësimi i planeve të biznesit do të bëhet nga ekspertë të jashtëm të fushës të nënkotruar nga Drejtoria e Përgjithshme, të cilët përgatisin një raport vlerësimi për cdo plan biznesi. Raportet e vlerësimit i dorëzohen Komisionit për Vlerësimin e Planit të biznesit i cili pasi shqyrton dhe miraton opinionet e Ekspertit, i rendit planet e biznesit sipas pikëve të vlerësuar në mënyrë të vecantë për secilin rajon. Pasi finalizon listën për cdo rajon, Komisioni shqyrton fondin në dispozicion dhe bën renditjen e aplikantëve.

Miratim dhe Kontraktim

Lista e miratuar e aplikantëve të aprovuar i dërgohet për njoftim strukturave vendore dhe strukturave rajonale për ndjekjen e procedurave. Fituesit e programit nënshkruajnë një kontratë me Struktura Rajonale dhe. Kontrata e standardizuar e Grantit nënshkruhet ndërmjet Drejtorit Rajonal dhe Përfituesit për një kohëzgjatje prej 12 muajsh nga dita e nënshkrimit dhe nga ky moment përfituesi ka 5 ditë kohë për regjistrimin e subjektit në Qendrën Kombëtare të Bizneseve (QKB)


Financimi dhe Monitorimi

Me nënshkrimin e kontratës së grantit, përfituesit i transferohet si paradhënie në llogarinë e tij të biznesit 20% e vlerës së grantit, shumë të cilën përfituesi duhet ta justifikojë me fatura të rregullta tatimore të shoqëruar me vërtetimin e kryerjes së pagesës si kusht për financimin e pjesës së mbetur të grantit. Pjesa e mbetur e vlerës disbursohet në jo më shumë se dy këste të tjera, me dorëzimin e faturave të rregullta tatimore dhe vërtetimit të kryerjes së pagesës brenda 4 muajve nga lidhja e kontratës standarte. Monitorimi i zbatimit kryhet nga zyrat vendore, drejtorite rajonale dhe drejtoria e përgjithshme e AKPA

Çfarë është **PROGRAMI I PUNËVE PUBLIKE NE KOMUNITET?**

Programi i punëve publike në komunitet është një program 12 mujor, i cili ka qëllim përfshirjen në tregun e punës të punëkërkuësve të papunë afatgjatë nëpërmjet ofrimit të mundësive të trajnimit dhe të punësimit me kohë të pjesshme në aktivitete me fokus shërbimet në dobi të komunitetit.

FUSHAT E VEPRAMTARISË SË PROGRAMIT



Punëdhënësi dhe Punëmarrësi me të drejtë përfitimi

Punëdhënësit (të regjistruar në zyrën e punës) me të drejtë përfitimi në këtë program janë:

- organizata jofitimprurëse,
- organizata vullnetare,
- organizata të shoqërisë civile,
- biznese sociale/sipërmarrje sociale/ndërmarrje sociale,
- organizata publike shtetërore të specializuara në këto fusha, të cilët zbatojnë projekte me interes publik, në nivel vendor dhe në favor të komunitetit, të cilat kanë kapacitetet dhe eksperiencën e duhur për zbatimin e këtyre projekteve.

Punëdhënësit kanë të drejtë të aplikojnë për maksimumi dy grupe, me numër jo më të madh se 7 (shtatë) punë kërkues të papunë secili grup.

Punëkërkuesit me të drejtë përfitimi janë të gjithë punëkërkuesit e papunë të regjistruar dhe aktivë, për jo më pak se 12 muaj në zyrën e punës, të moshës mbi 25 vjeç, pasi të kenë marrë shërbimet e nevojshme të punësimit, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, nga specialisti përkatës i punësimit.

MBIKQYRËSI

Në dispozicion të punëkërkesve të papunë, pjesëmarrës në këtë program, vihet një mbikëqyrës, sipas pikës 9, të kreut III, të këtij vendimi, i cili është përgjegjës për zhvillimin e planit individual të trajnimit (PIT) për çdo person të punësuar në projekt dhe për garantimin e zbatimit të këtij programi.

FINANCIMI

Punëkërkuesit e papunë pjesëmarrës:

- Financim i pagës në shumën 50% të pagës minimale, në shkallë vendi
- Kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore të llogaritura në bazë të pagës minimale në shkallë vendi, të ofruara gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit.
- Kupon për trajnim të punëkërkuesve të papunë, pjesëmarrës në program, deri në 20 000 (njëzet mijë) lekë, në rastet kur trajnimet e miratuara nuk ofrohen nga ofruesit publikë të arsimit dhe formimit profesional
- Përfitime të tjera shtesë si transporti, bonus për ndjekjen e kopshteve dhe çerdheve si dhe përshtatja e arsyeshme e vendit të punës, do të këtë për kategori me vulnerabilitete të shtuara.

Punëdhënësi pjesëmarrës:

- Për mbikëqyrësin, financim të pagës në shumën: i. 50% të pagës mesatare në shkallë vendi, për grupin nga 1–7 punëkërkues të papunë pjesëmarrës, për 20 orë në javë; ii. 100% të pagës mesatare në shkallë vendi, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, për grupin nga 1–14 punëkërkues të papunë pjesëmarrës, për 40 orë në javë.
- Kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesën e kontributeve të punëdhënësit), të llogaritura në bazë të pagës mesatare në shkallë vendi.
- Tarifë për mbulimin e shpenzimeve materiale, të nevojshme për zbatimin e projekteve të punësimit në komunitet, në shumën totale deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo përfitues.

Çfarë është **PROGRAMI I PUNËSIMIT TË PERSONAVE TË DALË TË PAPUNË SI PASOJE E COVID-19 ?**

Programi i punësimit është një program 4, 8 ose 12-mujor punësimi, në të cilin profili dhe nevojat e punëkërkuësit përshtaten me vendin e lirë nga punëdhënësi. Paga përcaktohet në kontratën e punës në përputhje me pozicionin përkatës dhe nivelin e pagave në treg.

TARGET GRUPI

Punëkërkesit me të drejtë përfitimi janë të gjithë punë Pu. Pa. që kanë dalë të papunë si pasojë e COVID-19, të evidentuar nga DPT dhe të regjistruar në ZP.

What's this?



LLOJET E PROGRAMEVE

Programi I punësimit katërmujor

Programi I punësimit tetëmuajor:

Programi i punësimit 12 muajor

PROGRAMI I PUNËSIMIT KATËRMUJOR



100% page minimale 2 muaj
Kontribute 4 muaj

M 1

M 2

M 3

M 4

Financimin e pagës në shumën 100% të pagës minimale në shkallë vendi, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, për 2 (dy) muaj për të gjithë pjesëmarrësit në program, të kompensuara në muajin e parë dhe të katërt të kontratës

Kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesë e kontributit të punëdhënësit), të llogaritura në bazë të pagës minimale në shkallë vendi, të ofruara gjatë të gjithë kohëzgjatjes së punësimit, të kompensuara çdo muaj.

PROGRAMI I PUNËSIMIT TETEMUJOR



100% page minimale 4 Muaj
Kontribute 8 muaj

M 1

M 2

M 3

M 4

M 5

M 6

M 7


M 8

Financimin e pagës në shumën 100% të pagës minimale në shkallë vendi, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, për 4 (katër) muaj për të gjithë pjesëmarrësit në program, të kompensuara në muajin e parë, të dytë, të shtatë dhe të tetë të kontratës

-Kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesë e kontributit të punëdhënësit), të llogaritura në bazë të pagës minimale në shkallë vendi, të ofruara gjatë të gjithë kohëzgjatjes së punësimit, të kompensuara çdo muaj.

PROGRAMI I PUNËSIMIT 12 MUJOR

Kontributet cdo muaj



kostot e financimit të sigurimeve të detyrueshme (kontribut i punëdhënësit dhe punëmarrësit) në masën 100%, të llogaritura në bazë të pagës minimale në shkallë vendi, të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, të ofruara gjatë të gjithë kohëzgjatjes së programit, të kompensuara çdo muaj.

FALEMINDERIT!

AKPA | AGJENCIA KOMBËTARE
PËR PUNËSIM DHE AFTËSI